

DITA KOMBËTARE E NDËRMJETËSIMIT

Përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ishin pjesë e aktivitetit të organizuar në kuadër të Ditës Kombëtare të Ndërmjetësimit, një nisme me në qendër dialogun si një mjet për të afruar drejtësinë me qytetarët.



VIZITË E TË RINJVE TË INSTITUTIT TË KULTURËS ROME NË SHQIPËRI (IRCA) PRANË MINISTRISE SË DREJTËSISË



Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore, znj. Patricia Pogaçe, u ftua ditën për të qenë pjesë e një vizite, e cila u zhvillua nga të rinj pjesë e Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në krah edhe të drejtuesve të tjera nga Ministria e Drejtësisë, znj. Pogaçe, ndau me të rinjtë informacion mbi ndihmën juridike falas.

VIZITË E PËRFAQËSUESVE TË AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION DHE UNDP NË QSHNJP KUKËS



Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore, znj. Patricia Pogaçe dhe specialistët e QSHNJP Tropojë e Kukës, mirëpritën në një takim përfaqësues të Austrian Development Cooperation dhe UNDP. Në takim u diskutua mbi ecurinë e qendrës ndër vite, mbështetjen e ofruar ndaj qytetarëve si dhe nevojat për zhvillimin e mëtejshëm.

TAKIME INFORMUESE NË FUSHË ARRËZ, MALËSI TË MADHE DHE VAUN E DEJËS MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS NË BASHKITË E VOGLA

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri dhe Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër zhvilluan takime informuese në Bashkinë Fushë Arrëz, Malësi e Madhe dhe Bashkinë Vau Dejës, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën për ndihmë juridike falas. Fokusi i këtyre takimeve ishte krijimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet DNJF dhe bashkive të vogla, për të siguruar akses të barabartë në drejtësi për çdo qytetar.



INTERVISTË PËR TV "ORA NEWS"



Intervistë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore, znj. Patricia Pogaçe, për TV "Ora News". Intervista u fokusua te kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas si edhe te Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore me numrin më të lartë të përfituesve të këtij shërbimi.

TRYEZË PUNE ME AVOKATËT TË CILËT OFROJNË NDIHMË JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI.



Përfaqësues nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ishin pjesë e tryezës së punës me avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Tryeza u organizua nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë dhe u zhvillua në formën e një diskutimi mbi problematikat dhe sfidat që hasen në ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

TAKIM INFORMUES ME PËRFAQËSUES TË PROKURORISË SË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve pjesë e skemës së Ndihmës Juridike Falas, si dhe në përmbushje të misionit për garantimin e aksesit në drejtësi për shtresat në nevojë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka zhvilluar një takim informues me përfaqësues të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Në takim ishin gjithashtu prezent edhe punonjësi i QSHNJP Dibër dhe QSHNJP Mat.



AKTIVITETE TË ZHVILLUARA NGA QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE



QSHNJP Durrës dhe QSHNJP Kavajë në datën 04.07.2025 zhvilluan një aktivitet Street Law pranë zonës së ish - Kënetës, Durrës. Aktiviteti ka në fokus informimin mbi ligjin nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

QSHNJP Durrës në datën 10.07.2025 zhvilloi një aktivitet informues Street Law në zonën e plazhit, Durrës.



QSHNJP Kavajë në datën 04.07.2025 zhvilloi një takim me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, me përfaqësues të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kavajë.

QSHNJP Kavajë zhvilloi një sesion informues Street Law mbi ligjin nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti".



QSHNJP Përmet në datën 11.07.2025 zhvilloi një takim informues mbi të drejtën për ndihmë juridike falas, pranë Qendrës së të Moshuarve në lagjen Mejden.

QSHNJP Përmet zhvilloi një intervistë për RTSH Gjirokastrë ku foli për kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas dhe ndërmjetësimin si një zgjidhje alternative ndaj gjykatave.



QSHNJP Përmet, në datën 29.07.2025 zhvilloi një tryezë ndërinstitucionale me përfaqësues të Shërbimit Përmbartimor dhe Shërbimit të Provës, në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave.



QSHNJP Përmet në datën 23.07.2025 ishte pjesë e një takimi të zhvilluar në Bashkinë Përmet. Takimi kishte në fokus diskutimin e çështjeve prioritare për komunitetin, transparencën dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet strukturave vendore dhe qytetarëve.



QSHNJP Përmet ishte pjesë e aktivitetit ndërinstitucional me temë: “Barazia Gjinore – Përfshirja dhe Bashkëpunimi për një Shoqëri më të Drejtë”.

QSHNJP Mat në datën 24.07.2025 ishte pjesë e ceremonisë së nënshkrimit të “Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore”.



QSHNJP Mat zhvilloi një takim informues mbi ndihmën ligjore falas me përfaqësues të organizatës “Motrat Dorote”. Gjatë takimit u diskutua mbi autorizimin dhe financimin e OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas.

QSHNJP Mat në kuadër të 30 Korrikut - Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave, bëri prezantimin e kësaj dite te qytetarët e Burrelit me anë të një aktiviteti Street Law.



QSHNJP Lushnje në datën 17.07.2025 ishte pjesë e aktivitetit me temë: Karta Evropiane për barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Aktiviteti u zhvillua në Bashkinë Divjakë me UN WOMEN në Shqipëri.



QSHNJP Lushnje në datën 17.07.2025, në kuadër të zhvillimit të takimeve informuese në bashkitë e vogla, zhvilloi një takim me përfaqësues të Bashkisë Divjakë. Gjithashtu në përfundim të takimit u zhvillua një aktivitet Street Law me qytetarët.



QSHNJP Lushnje në datën 28.07.2025 zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave, me individë përfitues të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Gjirokastrë mori pjesë në workshopin e datës 04.07.2025 me temë: “Prezantimi i Udhëzuesit për Shërbimet e Mbështetura të Punësimit për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Planifikimi Individual i Punësimit”.



QSHNJP Gjirokastrë në datën 16.07.2025 ishte pjesë e aktivitetit me temë: “Karta Evropiane për barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, në Bashkinë Dropull. U bë prezantimi i kartës për barazi gjinore”, për qasjen pozitive drejt zhvillimit social-ekonomik të burrave dhe grave, vajzave dhe djemve në Shqipëri, për eliminimin e diskriminimit dhe trajtimit ndryshe.



QSHNJP Gjirokastrë zhvilloi një intervistë me temë: “Ndihma juridike e garantuar nga shteti”, rastet e trajtuara përgjatë 6 mujorit të parë dhe shërbimet e ofruara”.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 01.07.2025 zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues mbi ndihmën juridike falas me pensionistë të këtij qyteti.



QSHNJP Gjirrokastër në datën 29.07.2025 zhvilloi në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave një takim me përfitues të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Gjirrokastër në datën 28.07.2025 ishte e ftuar në aktivitetin me temë: "Gjithëpërfshirje në vendin e punës: Shërbime të mbështetura punësimi për të gjitha aftësitë", për të diskutuar së bashku mbi krijimin e kushteve të punësimit dhe formimit profesional për personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Gjirrokastër.



QSHNJP Kurbin në datën 18.07.2025 realizoi një takim me përfaqësues të komunitetit Rom, në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave.

QSHNJP Elbasan në datën 18.07.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law mbi Ligjin Nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

QSHNJP Elbasan në datën 15.07.2025 zhvilloi një intervistë për Radio Televizionin Shqiptar me fokus promovimin e ndihmës juridike falas për qytetarët me të ardhura të pamjaftueshme.

QSHNJP Elbasan, në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave, zhvilloi një aktivitet Street Law ku u diskutua mbi përmbajtjen e legjislacionit shqiptar që synon parandalimin dhe ndëshkrimin e trafikimit të personave.

QSHNJP Elbasan, në kuadër të të zhvillimit të aktiviteteve në bashkitë e vogla, organizoi një takim në Bashkinë Cërrik, me përfaqësues nga Bashkia Cërrik, Shërbimet Sociale dhe QKMF.

QSHNJP Pogradec në datën 22.07.2025 realizoi një takim me Koordinatorin e Dhunës në Familje, Bashkia Pogradec Z. Arbi Basho.

QSHNJP Pogradec në datën 11.07.2025 organizoi një takim me Drejtuesen e Shërbimit Përmbartimor Pogradec Z. Athinela Lybedha. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dhe referimit të rasteve mes dy institucioneve.

QSHNJP Pogradec në kuadër të të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave organizoi një aktivitet informues Street Law.

QSHNJP Korçë, në kuadër të përmirësimit të aksesit në drejtësi dhe forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional, zhvilloi një takim me përfaqësues të institucioneve vendore, pranë Bashkisë Korçë.

QSHNJP Korçë në datën 04.07.2025, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, realizuan një takim, me kategorinë e veçantë persona me aftësi të kufizuara dhe të verbërit.

QSHNJP Korçë realizoi një intervistë për RTSH Korça, fokusi i së cilës ishin rastet e trajtuara përgjatë 6 muorit të parë të vitit 2025.

QSHNJP Korçë, në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave, realizoi një takim informues mbi ligjin 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti" me Z. Robert Haskaj, shef i seksionit për Hetimin e Trafikimeve të Paligjshme, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe specialistët e këtij sektori.



QSHNJP Tropojë në datën 28.07.2025 mori pjesë në akimin e anëtarëve të Grupit Teknik Ndërsëktorial (GTN). Në takim u diskutuan raste konkrete dhe ofrimi i këshillimit ligjor falas.



QSHNJP Tropojë, në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit, organizoi një takim me punonjësit e pikës doganore Morinë. Qëllimi i takimit ishte rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional me fokus kategorinë e personave të trafikuar të cilët mund të kenë nevojë për ndihmë juridike falas si një nga kategoritë e veçanta përfituese të ligjit 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".



QSHNJP Vlorë në datën 10.07.2025 zhvilloi një takim në Bashkinë Selenicë, Qarku Vlorë. Takimi u zhvillua në ambientet e Shkollës "Hajredin Beqari" në Selenicë, me përfaqësues nga disa prej drejtorive të qytetit.

QSHNJP Vlorë, në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave, zhvilloi një sesion informues me qytetarët mbi ndihmën juridike falas.



QSHNJP Shkodër zhvilloi një aktivitet Street Law në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave.

QSHNJP Lezhë zhvilloi në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave një aktivitet Street Law. Përgjatë këtij aktiviteti qytetarët u njohën me ligjin për ndihmën juridike falas dhe kategoritë përfituese.

QSHNJP Berat në datën 30.07.2025 organizoi një aktivitet Street Law në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave.



QSHNJP Pukë në datën 15.07.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law me fokus informimin e qytetarëve mbi ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

QSHNJP Kukës në datën 16.07.2025 ishte pjesë e takimit me tematikë "Së bashku, përtej kufijve, kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore". Takimi u mbajt në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Kukës dhe Komunës së Dragashit.



QSHNJP Tiranë në datën 09.07.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law në Ditën Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave.

QSHNJP Tiranë në datën 29.07.2025 zhvilloi në kuadër të Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Personave, një aktivitet Street Law. Në fokus të aktivitetit ishte sensibilizimi në lidhje me të drejtat dhe mekanizmat e mbrojtjes nga dhuna.



**QENDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
KANË ASISTUAR 107 PERSONA NË PËRDORIMIN E
PORTALIT E-ALBANIA.**